REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr.43, datë 20/07/2005

"PËR DETYRIMET FINANCIARE TË BASHKISË SË TIRANËS NDAJ PERSONAVE TË TRETË QË LIDHEN ME VENDIME GJYQËSORE TË FORMËS SË PRERË"

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" neni 32, gërma "g" dhe "dh", dhe në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 "Për miratimin e realizimit të buxhetit të vitit 2004 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë listën dhe shumat përkatëse të detyrimeve financiare të Bashkisë së Tiranës, që lidhen me vendime gjyqësore të formës së prerë ndaj personave të tretë, sipas **Tabelës Nr.1** pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

2. Të miratojë listën dhe shumat përkatëse të detyrimeve financiare të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, që lidhen me vendime gjyqësore të formës së prerë ndaj personave të tretë, sipas **Tabelës Nr.2** pjesë përbërëse të këtij Vendimi.

3. Efekti financiar prej 5.825.610 lekësh dhe 5500 $, konvertuar me kursin e ditës, sipas pikës 1 të këtij Vendimi, përballohet nga zëri "Detyrime gjyqësore" nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2005.

4. Efekti financiar prej 3.542.865 lekësh sipas pikës 2 të këtij Vendimi, të përballohet në shumën prej 2.742.865 lekësh nga zëri "shpenzime operative" të buxhetit të Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit, miratuar për vitin 2005 dhe në shumën prej 800.000 lekësh duke pakësuar zërin "detyrime gjyqësore" nga të ardhurat e Bashkisë së Tiranës për vitin 2005. Fondi prej 800.000 lekësh të transferohet në buxhetin e Drejtorisë së Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit për vitin 2005 me qëllim përmbushjen e detyrimeve.

5. Ngarkohet Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar, Drejtoria e Financës, Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Përgjithshme Nr.1 të Punëtorëve të Qytetit për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI